



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## AVOKATI I POPULLIT

### RAPORT

#### I

### MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

**lidhur me vizitën në pikën e kalimit kufitar  
Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë**

Drejtuar: Z. Xhelal Sfeçla, ministër  
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Gazmend Hoxha, drejtor i përgjithshëm  
Policia e Kosovës

Z. Fehmi Gjata, drejtor  
Policia e Kosovës, Departamenti për Kufi

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor  
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, 4 qershor 2024

## HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit (MKP) e ka vizituar pikën e kalimit kufitar në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë.

MKP-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social. Bazuar në mandatin e saj, MKP-ja, më 4 janar 2024, e ka vizituar pikën e kalimit kufitar Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë (ANP).

Gjithashtu, më 24 prill 2024, MKP-ja në bashkëpunim me Programin për të Drejta Civile/Kosovë (CRPK) dhe UNHCR, ka realizuar një vizitë të përbashkët në ANP.

### Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave për të huajt, të cilët, bazuar në Ligjin për të Huajt në Republikës së Kosovës dhe në ligjet tjera relevante, nuk mund të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, janë subjekt i kthimit në vendet nga kanë ardhur apo mbahen përkohësisht në hapësirat e mbajtjes në pikën hyrëse të ANP-së.

Ekipi i MKP-së gjatë vizitës ishte i përberë nga drejtoresha e MKP-së, këshilltarja juridike për parandalim të torturës dhe këshilltarja/punëtore sociale.

### Bashkëpunimi me MKP-në gjatë vizitës

1. Gjatë vizitave në këtë pikë të kalimit kufitar, bashkëpunimi i zyrtarëve policorë, të cilët ishin në detyrë, me MKP-në ka qenë i plotë. Ekipi ka pasur qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara dhe i janë siguruar të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën.

### Hapësirat e mbajtjes në pikën hyrëse të ANP-së

2. Të huajt, të cilët duan ta kalojnë kufirin e Republikës së Kosovës dhe për këtë nuk i plotësojnë kriteret ligjore, si dhe nëse avio-transportuesi nuk është në gjendje që ta bëjë kthimin e tyre të menjëhershëm, mbahen në hapësira të veçanta në ANP, deri në 72 orë. Këto hapësira njihen edhe si hapësira të mbajtjes në pikën hyrëse nëpër aeroporte. Gjatë vizitës MKP-ja nuk ka hasur në të huajt, të akomoduar në këto hapësira.

3. MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se personat e ndaluar në këto hapësira nuk janë të regjistruar në ndonjë regjistër të posaçëm. Sipas policisë kufitare, këta persona regjistrohen vetëm në formularin e policisë të cilët janë në ndërrim.

### Kushtet e akomodimit

4. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm: *KPT*), për të huajt e ndaluar, bazuar në Ligjin për të Huajt, të publikuara në vitin 1997,<sup>1</sup> përcaktojnë se personat e ndaluar mbi këtë bazë duhet të kenë në dispozicion mjete adekuate të fjetjes, të kenë qasje në valixhet e tyre dhe në hapësira adekuate sanitare dhe të pastrimit, si dhe ajrosje (dalje në ajër të pastër) në baza ditore. Më tej këto standarde përcaktojnë se i huajt në këto

<sup>1</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, pjesë nga Raporti i 7-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 1997. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce90e>.



hapësira duhet të ketë qasje në ushqim dhe, nëse është e nevojshme, duhet të ketë kujdes shëndetësor.

5. MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se këto dhoma ofrojnë kushte të pranueshme për akomodim, pastërtia ishte në nivel të duhur, tualete të furnizuara me mjete higjienike, dushe në gjendje shumë të mirë, shtretër me dollap si dhe dritë artificiale të mjaftueshme. Bazuar në pohimet e zyrtarëve të policisë kufitare, të huajve, të cilët mbahen në këto hapësira, u jepet mundësia të dalin në ajër të pastër (ajrosje) në baza ditore. Ekipi i MKP-së vlerëson se kushtet e akomodimit në këto dhoma janë sipas standardeve të Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës.

### **Shërbimet mjekësore**

6. Njësia shëndetësore, e cila funksionon në kuadër të ANP-së, është shërbim i cili organizohet nga ANP-ja. Ekipi i MKP-së ka vizituar këtë pjesë shëndetësore, me ç' rast është thënë se të ndaluarit vizitohen në raste emergjente nga kjo njësi.

7. Sipas zyrtarëve të policisë kufitare, në rast se për të huajin e mbajtur në këto hapësira nevojitet shërbim më i specializuar në institucione të tjera publike shëndetësore jashtë ANP-së, ai dërgohet në këto institucione, nën përcjelljen e zyrtarëve policorë.

### **Kontaktet me botën e jashtme**

8. MKP-ja konsideron se është shumë e rëndësishme që të huajt, të cilët mbahen në këto hapësira, të kenë kontakte me botën e jashtme. Në dispozicion të të huajve për kontakte me botën e jashtme është qasja në internet përmes “wi-fi”-së. Ekipi i MKP-së gjatë vizitës ka vërejtur se në dhoma të huajt e ndaluar nuk kanë informata se si të kyçen në “wi-fi”.

9. Në raportin për vizitën në aeroportin ndërkombëtar të një shteti në rajon në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, KPT-ja, pas vizitës, u kishte rekomanduar autoriteteve të shtetit që të huajve të ndaluar t'u ofrojnë së paku një orë ajrosje, nëse ata qëndrojnë në hapësirat e mbajtjes në pikat hyrëse. Gjithashtu duhet të kenë në dispozicion një varg informatash, në disa gjuhë, lidhur me statusin e tyre ligjor si dhe për të drejtat e tyre, e po ashtu të kenë qasje në shërbime mjekësore, nëse e kërkojnë një gjë të tillë.<sup>2</sup>

10. Gjatë vizitës, MKP-ja ka vërejtur se në dhomat ku akomodohen të huajt, të cilët nuk mund ta kalojnë kufirin e Republikës së Kosovës, nuk ka informata të afishuara se kujt dhe si mund t'i drejtohen ata nëse kanë ankesa për sa i përket trajtimit nga zyrtarët policorë, apo nëse duan të dinë për statusin e tyre ligjor dhe për të drejtat e tyre. Vlen të ceket se Avokati i Popullit, përmes raportit me rekomandime, më 7 maj 2019, u kishte rekomanduar autoriteteve përgjegjëse: *“Hapësirat e mbajtjes në pikat hyrëse të ANP-së të pajisen me informata relevante në gjuhë të ndryshme, përmes së cilave të huajt njoftohen për të drejtat e tyre, për statusin e tyre ligjor, si dhe për të drejtën për të kontaktuar me mekanizmat për mbrojtjen e drejtave të njeriut.”*<sup>3</sup>

11. Ekipi i MKP-së ka vërejtur se dhomat ende nuk janë pajisur me informata të nevojshme, përmes të cilave të huajt mund të njoftohen për të drejtat e tyre, si dhe informata për mundësinë e kontaktit me mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe në gjuhë të

<sup>2</sup> Për më shumë, shih në: <https://rm.coe.int/1680697c94>.

<sup>3</sup> <https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/05/Raport-me-rekomandime-i-MKPT-p%C3%ABr-vizit%C3%ABn-n%C3%AB-Pik%C3%ABn-e-Kalimit-Kufitar-AN-Adem-Jashari-n%C3%AB-Prishtin%C3%AB.pdf>

ndryshme dhe, siç u theksua me lart, nuk ka informata lidhur me mundësinë e qasjes në “wi-fi”. Ekipi i MKP-së ka vërejtur se ekzistojnë broshurat në gjuhë të ndryshme në zyrat e policisë, por konsideron se ato duhet të jenë të vendosura dhe të jenë të dukshme në dhomat e ndalimit.

Avokati i Popullit konstaton se policia nuk posedon regjistra për regjistrimin e personave të ndaluar, ku do të shënoheshin detajet e personave të ndaluar, gjinia, koha e mbajtjes etj. Gjithashtu Avokati i Popullit konstaton se dhomat e ndalimit nuk kanë informata të mjaftueshme për të drejtat e tyre dhe as informata të tjera të dobishme për të ndaluarit.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës në ANP, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon:

#### **Ministrisë së Punëve të Brendshme:**

- *Të krijohet një regjistër i posaçëm për të ndaluarit në dhomat e ndalimit në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë.*
- *Hapësirat e mbajtjes (ndalimit) në pikat hyrëse të Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë të pajisen me informata relevante në gjuhë të ndryshme (poster dhe broshura), përmes së cilave të huajt njoftohen për të drejtat e tyre, për statusin e tyre ligjor, si dhe për të drejtën për të kontaktuar me mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Po ashtu të vendosen edhe informatat lidhur me “wi-fi”-në.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit